

Nga viti 2004 ekziston nje qender virtuale studimi mbi ekologjine e ekosistemeve te tranzicionit te Mesdheut dhe te Detit te Zi, e cila lind nga nje projekt evropian INTERREG III B CADSES. Qendra virtuale e studimeve eshte aktiv ne sitin projektit TWReferenceNET. Kjo qender studimore eshte nje pike informacioni per administraten shtetere dhe per qytetaret mbi rolin e specieve shtegtare dhe te ekosistemeve lagunore bregdetare ne perhapjen e gripit te shpendeve. Qendra studimore permban informacione mbi llojet e shumta te specieve te egra ne zonat bregdetare, ben te mundur pranine e eksperteve per t'iu pergjigjur online pyetjeve mbi kete çeshtje ne nje forum te dedikuar te hapur te homepage www.twreferencenet.com. Sherbimi eshte i organizuar nga njesia operative e Triestes dhe e provinces se Leçes.

Problemi shqetesues i gripit te shpendeve do te jete pjese e informacionit te web sitit. Ne Shqiperi institucionet qe ndjekin kete problem koordinohen nga Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit. Eshte ngritur nje Task Force nen drejtimin e Ministrit te Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit dhe me pjesmarrjen e Zevendesministrit te Shendetesise, Zevendesministrit te Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave, dhe perfaqesues te institucioneve shkecore. Deri me tash nuk kemi te evidentuar asnje rast me semundje ne shpend. Ministria e Mjedisit po vazhdon konsultimet me te gjitha aktoret per problemin e gjuetise e shpendeve te eger (kryesisht ata shtegtare) qe mbetet nje potencial rreziku per popullaten.

Zamir Dedei